



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2018





SHQIPËRIA NË SHIFRA 2018

SHQIPËRIA NË SHIFRA 2018

Drejtor botimi: **Delina Ibrahimaj**

Punoi: INSTAT

© Copyright INSTAT 2019

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al


PËRMBAJTA

POPULLSIA.....	5
STATISTIKAT E KONSUMIT TË NJeF-ve.....	8
STATISTIKAT E KUSHTEVE TË BANIMIT TË NJeF-ve.....	9
SHËNDETËSIA.....	10
STATISTIKATE KRIMEVE.....	12
ARSIMI.....	15
STATISTIKATE KULTURËS.....	18
PUNËSIMI.....	20
PAPUNËSIA.....	22
ÇMIMET DHE KONSUMI.....	23
LLOGARITË KOMBËTARE.....	25
TREGTIA E JASHTME.....	26
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT.....	27
MJEDISI.....	29
PLAZHET.....	31
PESHKIMI.....	32
BLEGTORIA.....	33
BUJQËSIA.....	34
TRANSPORTI.....	36
TURIZMI.....	37


POPULLSIA



LINDJET, VDEKJET DHE MIGRACIONI NETO



POPULLSIA MË 1 JANAR SIPAS GRUPMOSHAVE



Popullsia e Shqipërisë në 1 Janar 2019, rezultoi 2,86 milionë banorë duke pësuar rënie prej 0,3 %, krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2018, kanë lindur rreth 29 mijë foshnje, ndërsa kanë vdekur rreth 22 mijë persona. Numri i lindjeve vazhdon të tejkalojë numrin e vdekjeve, pavarësisht se diferenca midis tyre po ngushtohet me kalimin e viteve. Kjo diferencë në vitin 2018 është rreth 7 mijë banorë. Nga ana tjetër, migracioni neto vazhdon të mbetet negativ (diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve), duke rezultuar rreth 15 mijë persona për vitin 2018.

Të moshuarit në Shqipëri paraqesin nga viti në vit një tendencë në rritje. Në 1 Janar 2019, grupmosha 60-79 vjeç zë 17,7 % nga 17,1 % të popullsisë gjithsej në 1 Janar të vitit 2018. Tendencë në rritje shfaq edhe grupmosha mbi 80 vjeç.

Grupmosha 0-14 vjeç paraqet tendencë në rënie, duke zënë 17,2 % në 1 Janar të vitit 2019, krahasuar me 17,7 % që zinte në 1 Janar të vitit 2018. Ulja e numrit të të rinjve dhe rritja e numrit të të moshuarve, pra plakja e popullsisë vjen si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë.



Në 1 Janar 2019, Qarku i Tiranës zë 31,3 % të popullsisë gjithsej, duke vazhduar të jetë një nga qarqet më të populluara të vendit, ndjekur nga Fieri (10,3 %), Durrësi (10,1 %) dhe Elbasani (9,6 %).

Vetëm 3 qarqe pësuan rritje të popullsisë gjatë viteve 2018-2019, përkatësisht Tirana, Durrësi dhe Vlora. Të gjitha qarqet e tjera pësuan një tkurrje të numrit të popullsisë gjatë periudhës 2018-2019 dhe kjo vjen kryesisht si pasojë e lëvizjeve të brendshme, drejtuar në qendrat urbane, kryesisht në Tiranë si dhe në Durrës e Vlorë.

Në 1 Janar 2019, qarku i Gjirokastrës paraqet numrin më të ulët të popullsisë, duke zënë 2,1 % të popullsisë gjithsej, i ndjekur nga qarku i Kukësit i cili zë 2,7 % të saj.

Në vitin 2018 jetëgjatësia për femrat është 80,5 vjet dhe për meshkujt 77,4 vjet.

Indeksi sintetik i fekunditetit vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit (2,1 fëmijë për grua). Në vitin 2018 numri mesatar i fëmijëve për grua është 1,37, duke shënuar një rënie krahasuar me vitin 2017, ku ky indeks ishte 1,48 fëmijë për grua.

Në vitin 2018 mosha mesatare në martesë si për meshkujt dhe për

POPULLSIA E SHQIPËRISË

	Njësia	2017	2018	2019
Popullsia në 1 Janar	Milion	2,88	2,87	2,86
0-14	në përqindje	18,2	17,7	17,2
15-59	-	63,0	62,7	62,4
60-79	-	16,5	17,1	17,7
80 +	-	2,4	2,5	2,7
Popullsia sipas qarqeve				
Berat	në mijë	132	127	125
Dibër	-	126	121	119
Durrës	-	285	290	290
Elbasan	-	284	279	275
Fier	-	303	298	295
Gjirokastrë	-	66	63	61
Korçë	-	214	210	208
Kukës	-	80	77	77
Lezhë	-	129	127	125
Shkodër	-	208	205	203
Tiranë	-	862	884	895
Vlorë	-	189	189	189



A E DINI SE

Në vitin 2018 jetëgjatësia për femrat është 80,5 vjet dhe për meshkujt 77,4 vjet.



TREGUES KRYESOR PËR POPULLSINË E SHQIPËRISË

	Njësia	2016	2017	2018
Jetëgjatësia	vite			
Meshkuj	-	77,0	77,1	77,4
Femra	-	80,1	80,0	80,5
Indeksi sintetik i fekonditetit	për grua	1,54	1,48	1,37
Mosha mesatare në martesë	vite			
Meshkuj	-	30,4	31,5	30,2
Femra	-	25,1	26,5	25,5
Martestat	për 1000 banorë	7,8	7,9	8,1
Lindjet	-	11,0	10,7	10,1
Vdekjet	-	7,4	7,7	7,6
Vdekshmëria foshnjore	për 1000 lindje	8,7	8,0	8,9
Vdekshmeria nën 5 vjeç	-	10,2	9,2	10,1

femrat ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2017. Një burrë martohet në moshën 30,2 vjeç dhe një grua në moshën 25,5 vjeç.

Vdekshmëria foshnjore në vitin 2018 është rreth 9 vdekje për mijë lindje të gjalla, duke pësuar një rritje krahasuar me 2017.

INDEKSI SINTETIK I FEKONDITETIT
Numri mesatar i fëmijëve që një grua mund të lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese 15-49 vjeç.

JETËGJATËSIA MESATARE NË LINDJE
Numri mesatar i viteve që një i lindur sot pritet të jetojë, duke marrë parasysh normat korrente të vdekshmërisë.



AEDINISE


Amelia dhe Noel janë emrat më popullore për të sapolindurit gjatë vitit 2018. Ajla dhe Amar janë emrat e dytë më popullore për të sapolindurit gjatë vitit 2018. Dhëndri më i ri i martuar në vitin 2018 është 18 vjeç, ndërsa nusja më e re është 15 vjeç.



STATISTIKAT E KONSUMIT TË NJEF-ve

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF-ve në Shqipëri. Sipas Anketës së Buxhetit të Familjes 2017, struktura e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF-ve sipas 12 grupeve kryesore të konsumit, tregon se grupet “Ushqime, pije alkoolike dhe duhan” zënë peshën kryesore në buxhetin familjar me 47,6 %. Këto grupe shënojnë uljen të shpenzimeve mesatare për konsum mujor në vitin 2017, me 1,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016. Një rritje e lehtë është regjistruar në grupet “Shëndet” dhe “Restorante dhe Hotele” me 0,5 pikë përqindje. Grupet e shpenzimeve për banesën (energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira e paguar) dhe mobilim zënë 15,7 % të totalit të buxhetit familjar, duke shënuar rritje prej 0,5 pikë përqindje, krahasuar me vitin e mëparshëm. Përqindja e buxhetit të NjEF-ve për grupin “Arsim”, zë një peshë prej 3,9 %, duke shënuar ulje prej 0,5 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016.

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË GRUPEVE KRYESORE TË KONSUMIT



AEDINISE

Shpenzimet për pushime në Shqipëri zënë 24,4 %, ndërsa shpenzimet për pushime jashtë Shqipërisë, përbëjnë 11,1 % ndaj grupit kryesor “Argëtim dhe Kulturë”.

STATISTIKAT E KUSHTEVE TË BANIMIT TË NJEF-VE



TABELA.1 NJEF SIPAS LLOJIT TË BANESËS (NJEF NË %)

Lloji i banesës	2015	2016	2017
Shtëpi për një familje	75,4	70,9	71,7
Banesë në një ndërtesë me deri 15 apartamente	13,6	16,0	14,8
Banesë në një ndërtesë me më shumë se 15 apartamente	10,7	12,4	13,1
Tjetër	0,3	0,7	0,4

TABELA.2 NJEF SIPAS SIPËRFAQES SË PËRDORUR TË BANESËS (NJEF NË %)

Sipërfaqja e banesës	2015	2016	2017
Më pak se 50 m ²	7,8	7,1	7,5
51-90 m ²	53,7	52,9	50,6
91-130 m ²	31,3	33,8	34,8
Më shumë se 130 m ²	7,1	6,2	7,1

TABELA.3 NJEF SIPAS STATUSIT TË PRONËSISË SË BANESËS (NJEF NË %)

Statusi i pronësisë	2015	2016	2017
Pronar ose duke u berë pronar (ka marrë hua, kredi ose në pritje të legalizimit)	93,0	91,8	93,0
Me qira (nga një person privat ose nga shteti)	5,5	6,3	5,4
Jeton falas /e ka në përdorim /tjetër	1,5	1,9	1,6

Burimi "Anketa e Buxhetit të Familjes 2015, 2016, 2017"

Sipas Anketës së Buxhetit të Familjes 2017, 71,7 % e Njësive Ekonomike Familjare (NJEF) jetojnë në shtëpi private, përqindje e cila regjistron rritje prej 0,8 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016. NJEF të cilat jetojnë në banesa që janë pjesë të ndërtesave me 15 apartamente zënë 14,8 %. Ndërsa banesa që janë pjesë të ndërtesave me 15 apo më shumë apartamente zënë 13,1 % të NJEF-ve në Shqipëri (Tabela 1).

Në vitin 2017, banesat me sipërfaqe 51 deri në 90 metra katrorë zënë peshën më të madhe me 50,6 %. Banesat me sipërfaqe 91-130 metra katrorë renditen në vendin e dytë përta i përket shpërndarjes, me 34,8 %, duke shënuar një rritje prej 1,0 pikë përqindje, krahasuar me vitin e mëparshëm (Tabela 2).

Pjesa më e madhe e e banesave, 93,0 % janë në pronësi të familjeve. Kategoritë e tjera, banesa të marra me qira ose falas, zënë një përqindje shumë të vogël të banesave ku NJEF-ve jetojnë, përkatësisht 5,4 dhe 1,6 % (Tabela 3).



Rreth 72.0 % e familjeve jetojnë në shtëpi private.



SHËNDETËSIA

Shpenzimet publike në shëndetësi

Shpenzimet publike në sektorin e shëndetësisë për vitin 2018 kanë qenë rreth 49 miliardë lekë.

Për vitin 2018, këto shpenzime përbëjnë 10,3 % të shpenzimeve gjithsej dhe zënë një peshtë prej 3,0 % në PBB-në gjithsej. Krahasuar me vitin 2017, shpenzimet publike në shëndetësi shprehur si përqindje ndaj PBB-së kanë shënuar rritje prej 3,1 %, ndërkohë shpenzimet publike në shëndetësi shprehur si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rritje prej 4,7 %.


Stili i jetesës

Hipertensioni dhe diabeti, së bashku me duhanpirjen janë faktorë madhorë risku për sëmundjet e qarkullimit të gjakut, të cilat nga ana e tyre përbëjnë shkaktarin kryesor të vdekjeve në popullsinë e Shqipërisë.

Për vitin 2018 prevalenca për hipertensionin është 870 për 10 mijë banorë dhe për diabetin 274 për 10 mijë banorë.


Të dhënat e studimit demografik dhe shëndetësor në Shqipëri (ADHS), në periudhën 2017- 2018, tregojnë se 5,0 % e femrave dhe 36,0 % e meshkujve të moshës 15-49 vjeç ishin duhanpirës. Në vitin 2018, të dhënat e konsumit të alkoolit tregojnë se më shumë se 1 në 4 femra (28,0 %) dhe 6 në 10 meshkuj

SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI



Burimi i informacionit: Ministria e Financave

PËRQINDJA E KONSUMIT TË DUHANIT DHE ALKOOLIT SIPAS GJINISË, ADHS 2018/19




A EDINISE

Në vitin 2018 shpenzimet për sektorin e shëndetësisë zënë 10,3 % të shpenzimeve gjithsej.



PËRQINDJA E KONSUMIT TË REKOMANDUAR TË FRUTAVE DHE PERIMEVE, ADHS 2018/19



(60,0 %), të moshës 15-49 vjeç kanë konsumuar alkool.

Në vitin 2018, 36,0 % e femrave dhe 14,0 % e meshkujve të moshës 15-49 vjeç kanë konsumuar numrin e rekomanduar të porcioneve ditore për konsumin e frutave. Në vitin 2018 u vërejt se konsumi i rekomanduar i perimeve është i ulët si tek meshkujt dhe tek femrat, pavarësisht moshës, vendbanimit, nivelit të arsimit apo pasurisë familjare (6,8 % tek femrat dhe 2,6 % te meshkujt).¹

Shkaqet e vdekjeve

Numri i vdekjeve në vitin 2018 është 21.804 duke pësuar një rënie prej 1,9 %, krahasuar me një vit më parë. Në rastet gjithsej, 93,8 % janë nga shkaqe natyrale, aksidentet janë shkak i dytë kryesor i vdekjeve të raportuara në vend i cili në harkun kohor të katër viteve është në shifra të njëjta.

Shkaqet e vdekjeve	2016	2017	2018
Natyrale	87,4	90,1	93,8
Aksident	2,1	2,1	2,1
Vetëvrasje	1,1	0,9	1,0
Vrasje	0,4	0,3	0,3
Aksident në punë	0,2	0,3	0,3
E panjohur	8,8	6,3	2,5



A EDINISE

Në vitin 2018, 36,0 % e femrave dhe 14,0 % e meshkujve të moshës 15-49 vjeç kanë konsumuar numrin e rekomanduar të porcioneve ditore për konsumin e frutave.

1. Konsumi i rekomanduar i perimeve është 4 ose më shumë porcione në ditë. Konsumi i rekomanduar i frutave është 3 ose më shumë në ditë. Për referencë botimi ADHS 2018/19 <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/ADHS-2017-18-Complete-PDF-FINAL-ilovepdf-compressed-1.pdf>




STATISTIKAT E KRIMEVE

Në vitin 2018 janë evidentuar gjithsej 34.468 vepra penale. Autorë të dyshuar për vepër penale, në vitin 2018 janë regjistruar 39.649. Ndërkohë janë regjistruar 19.101 persona të dëmtuar.

Në vitin 2018, qarqet me numrin absolut më të madh të dëmtuarve janë Tirana, Vlora dhe Durrësi. Në raport me popullsinë, qarqet me normën më të lartë janë Vlora me 113, Gjirokastra me 93 dhe Lezha me 83 të dëmtuar për 10 mijë banorë. Ndërkohë qarqet me normën më të ulët janë Fieri me 42, Dibra me 43 dhe Shkodra me 49 të dëmtuar për 10 mijë banorë.

TË DËMTUAR NGA VEPRAT PENALE SHPREHUR PËR 10.000 BANORË, 2018



A EDINISE

Qarqet me numrin absolut më të madh të personave të dëmtuar nga vepër penale janë Tirana, Vlora dhe Durrësi.



TË DËMTUAR NGA VEPRAT PENALE SHPREHUR PËR 10.000 BANORË, 2018

Vepra penale kundër personit	Vepra penale	Autorë
Krime kundër jetës	1.567	1.742
Vrasje	51	60
Vrasje mbetur tentativë	114	149
Vrasje nga pakujdesia	3	3
Kanosje	1.388	1.518
Të tjera	11	12
Krime kundër shëndetit	2.509	3.279
Plagosje e rëndë me dashje	129	190
Plagosje e lehtë me dashje	1.115	1.469
Dëmtime të tjera me dashje	1.249	1.605
Të tjera	16	15
Krime seksuale	110	114
Vepra penale kundër lirisë së personit	203	251
Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë	23	28
Heqja e paligjshme e lirisë	32	53
Dhunim banese	110	121
Të tjera	38	49
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	459	457
Prostitucioni	20	39
Shfrytëzim prostitucioni	77	73
Mbajtja e lokaleve për prostitucion	16	17
Fyerja	86	98
Përndjekja	195	186
Të tjera	65	44
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1.559	1.656
Braktisja fëmijës së mitur	84	84
Trafikimi i të miturit	8	9
Dhuna në familje (130/a)	1.374	1.459
Të tjera	93	104
Të tjera kundër personit	28	29
Gjithsej	6.435	7.528

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Shënim: Autorë janë persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale

Në vitin 2018 janë evidentuar 6.435 vepra penale kundër personit, 3,0 % më pak, krahasuar me vitin 2017. Veprat penale kundër personit përbëjnë 18,7 % të totalit të gjithë veprave penale të evidentuara për vitin 2018.

Në vitin 2018, janë regjistruar 7.528 autorë të dyshuar për vepra penale kundër personit, 4,9 % më pak, krahasuar me vitin 2017. Krime kundër shëndetit përbëjnë numrin më të madh të veprave penale dhe autorëve të regjistruar, ndjekur më pas nga krimet kundër jetës dhe veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.


A EDINISE

Qarqku me normë më të ulët të të dëmtuarve është Fieri me 42 të dëmtuar për 10 mijë banorë.



Ndër autorët e dyshuar për veprat penale kundër personit, 9,0 % janë femra dhe 91,0 % janë meshkuj. Femrat zënë përqindjen më të madhe si autore në veprat penale kundër moralit dhe dinjtetit, respektivisht me 16,0 %.

FIG 1. AUTORËT E VEPRAVE PENALE KUNDËR PERSONIT SIPAS GJINISË, 2018




A EDINISE

Gjatë vitit 2018, u evidentuan mesatarisht rreth 4 Kanosje në ditë.¹

1. Neni 84 Kodi Penal



SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM



* Të dhënat janë paraprake

Burimi i informacionit: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpenzimet publike në arsim për vitin 2018 kanë qenë 51,6 miliardë lekë. Këto shpenzime përbëjnë 10,9 % të shpenzimeve publike gjithsej dhe zënë një peshë prej 3,2 % në PBB-në gjithsej.

Në vitin 2018, u regjistruan në të gjithë nivelet e arsimit zyrtar, 641.161 nxënës dhe studentë, me një ulje prej 1,8 %, krahasuar me të regjistruarit e vitit 2017.

Në fillim të vitit shkollor 2018-2019 pjesëmarrja në të gjithë nivelet e arsimit, në krahasim me popullsinë e moshës shkollore ose GER (Raporti i Regjistrimeve Bruto), ishte 84,4 %. Megjithatë raporti i regjistrimit bruto është i ndryshëm në nivele të ndryshme arsimore.

Për vitin shkollor 2018-2019, GER në arsimin 9 vjeçar ishte 99,7 %, me një ulje prej 1 pikë përqindje nga viti paraardhës. Raporti tregon për pjesëmarrje të lartë të popullsisë në këtë nivel arsimor, që ka të bëjë edhe me faktin se arsimi 9 vjeçar është i detyruar. GER në arsimin e mesëm është 95,6 %, ndërsa në arsimin e lartë është 60,3 %.

NER (Raporti i Regjistrimeve Neto) llogaritet vetëm për arsimin

NXËNËS DHE STUDENTË TË REGJISTRUAR GJITHSEJ NË ARSIM

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	2016-17	2017-18	2018-19
Të regjistruar gjithsej në arsim		677.818	652.592	641.161
0	Në Kopshte	81.194	81.026	78.942
1+2	Në arsimin 9 vjeçar:	328.100	319.671	306.530
1	Filllore	174.836	170.861	167.104
2	Cikli i lartë i arsimit 9 vjeçar	153.264	148.810	139.426
3	Në arsimin e mesëm:	127.114	120.062	116.646
34	Gjimnaz dhe Social-Kulturor	106.133	99.457	95.359
35	Profesional	20.981	20.605	21.287
5 deri 8	Në arsimin e lartë	141.410	131.833	139.043

Burimi i informacionit: Të dhënat administrative nga MASR dhe MFE



A EDINISE

Në vitin 2018, u regjistruan në të gjithë nivelet e arsimit zyrtar, 641.161 nxënës dhe studentë.




parauniversitar. Në vitin 2018 morën pjesë në arsimin 9 vjeçar 95,6 % nxënës të grup moshës 6-14 vjeç në krahasim me popullsinë përkatëse, përkundrejt 96,5 % të tyre, në vitin 2017. NER në arsimin e mesëm, ishte, 77,4 % përkundrejt 76,7 % që ishte në vitin 2017.

Në vitin shkollor 2018-2019, marrin pjesë në arsimin publik, 92,3 % e nxënësve të arsimit 9 vjeçar dhe 87,6 % e nxënësve të arsimit të mesëm. Pjesëmarrja në arsimin e mesëm profesional paraqitet me rritje në vitet e fundit. Në vitin shkollor 2018-2019 marrin pjesë në arsimin profesional 18,3 % e nxënësve të arsimit të mesëm gjithsej, ndërsa vetëm në arsimin publik kjo përqindje është 18,9 %.

Në vitin 2018 përfunduan studimet në arsimin 9 vjeçar dhe u diplomuan 37.795 nxënës. Këtë vit përfunduan studimet në arsimin e mesëm dhe u diplomuan 35.278 nxënës, me një raport bruto të diplomimit GGR prej 78,3 %. Ky raport ka pësuar një ulje prej 1,8 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2017.

PJESËMARRJA NË ARSIM SIPAS RAPORTEVE GER DHE NER (%)



RAPORTI NXËNËS PËR MËSUES, PTR

Niveli ISCED	Viti shkollor	2016-17	2017-18	2018-19
Në arsimin publik				
1	<i>Fillore</i>	18.2	17.8	17.4
2	<i>Cikli i lartë i arsimit 9 vjeçar</i>	10.4	10.1	9.5
3	<i>Arsimi i mesëm</i>	14.4	13.8	13.3
Në arsimin privat				
1	<i>Në fillore</i>	15.1	15.0	14.5
2	<i>Në ciklin e lartë të 9 vjeçares</i>	7.6	7.7	7.5
3	<i>Në arsimin e mesëm</i>	9.0	8.7	8.5




AEDINISE

Në vitin shkollor 2018-2019 marrin pjesë në arsimin profesional 18,3 % e nxënësve të arsimit të mesëm gjithsej, ndërsa vetëm në arsimin publik kjo përqindje është 18,9 %.




SHKALLA E DIPLOIMIT NË ARSIMIN E MESËM, GGR (%)



Të diplomuarit e arsimit profesional përbëjnë 11,9 % të të diplomuarve të arsimit të mesëm, me një ulje prej 0,5 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2017.

Në vitin 2018, janë diplomuar në arsimin e lartë 34.331 studentë ose 3,0 % më pak se në vitin 2017. Ndër të diplomuarit e këtij viti, femrat përbëjnë 63,3 % të të gjithë programeve. Të diplomuarit në programet Bachelor përbëjnë 58,6 % të studentëve të diplomuar gjithsej.

TË DIPLOMUAR NË ARSIMIN E LARTË SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT, 2018



Fusha e studimit që zë peshën më të lartë ndër 10 fushat e gjera të studimit, për të diplomuarit e vitit 2018, është ajo e “Biznes, administrim dhe ligjit” në të cilën janë diplomuar 28,4 % e studentëve gjithsej. Pikërisht kjo fushë studimi ka qenë më e preferuar si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat.

Fusha e dytë më e preferuar për femrat është “Shëndet dhe mirëqenie”, ndërsa për meshkujt “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim”, e njëjtë me dy vitet paraardhëse.



STATISTIKAT E KULTURËS

Gjatë vitit 2018, numri i shfaqjeve

në institucionet

qendrore të artit ka

pësuar rritje me 22,0

%, krahasuar me një

vit më parë, ndërsa

numri i spektatorëve

është rritur me rreth 2,5 %. Në

institucionet kombëtare të artit, gjatë

vitit 2018 janë organizuar 80 premiera

dhe 1.036 shfaqje ku kanë marrë

pjesë 393.420 spektatorë. Në teatrot

kombëtare, TKP, TKOB dhe TKEKS, janë

realizuar 718 shfaqje, duke pësuar një

rritje me 27,1 %, krahasuar me vitin

2017, ndërsa numri i spektatorëve ka

shënuar një rënie me 4,1 % krahasuar

me vitin e mëparshëm. Qendra

Kombëtare e Kulturës për fëmijë gjatë

vitit 2018 ka zhvilluar 200 shfaqje dhe

7 premiera ku kanë marrë pjesë 22.205

spektatorë me një rritje prej 12,2 %, krahasuar

me vitin e mëparshëm. Një

situatë e ngjashme paraqitet edhe

për Cirkun Kombëtar i cili ka zhvilluar

118 shfaqje dhe 3 premiera gjatë

vitit 2018, një premierë më shumë,

krahasuar me një vit më parë, ndërsa

numri i spektatorëve është rritur me

145 %.

NUMRI I SHFAQJEVE/PREMIERAVE/SPEKTATORËVE NË INSTITUCIONET E ARTIT

	Nr i shfaqjeve			Nr i premierave			Nr spektatoreve		
	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Teatri Kombëtar Popullor	118	143	156	10	18	10	39.649	48.895	39.503
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	131	102	105	11	20	40	31.580	257.055	230.004
Teatri Kombëtar Eksperimental	338	320	457	15	15	20	39.475	43.567	65.739
Qendra Kombëtare e Kulturës për fëmijë	202	178	200	3	2	7	26.538	19.794	22.205
Cirku Kombëtar	133	106	118	4	2	3	28.484	14.682	35.969

Shënim: Në numrin e spektatorëve në Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, për vitin 2017 dhe 2018 janë përfshirë edhe shfaqjen në shesh.




A EDINISE

Qendra Kombëtare e Kulturës për fëmijë gjatë vitit 2018 ka zhvilluar 200 shfaqje dhe 7 premiera ku kanë marrë pjesë 22.205 spektatorë me një rritje prej 12,2 %, krahasuar me vitin e mëparshëm.



VIZITORË NË MUZE, PARQE ARKEOLOGJIKE DHE KALA



Numri i vizitorëve në muze në vitin 2018 është 311.940, duke shënuar rritje me 44,7 %, krahasuar me 2017. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 53,4 %, në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017. Në parqet arkeologjike, numri i vizitorëve është 377.845, me një rritje prej 50,8 %, krahasuar me vitin e mëparshëm. Numri i vizitorëve në muze, kala e monumente të tjera, si dhe në parqe arkeologjike, për vitin 2018 është 998.441, duke shënuar rritje me 49,2 %, krahasuar me vitin 2017.



A EDINISE

Në parqet arkeologjike, numri i vizitorëve është 377.845, me një rritje prej 50,8 %, krahasuar me vitin e mëparshëm.




PUNËSIMI

Në vitin 2018, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 59,5 %. Në Shqipëri meshkujt janë më aktivë në tregun e punës. Shkalla e punësimit për meshkujt 15-64 vjeç në vitin 2018 ishte 66,7 %, ndërsa për femrat 52,4 %, me një hendek gjinor në punësim prej 14,3 pikë përqindje.

Në nivel vendi, për vitin 2018, sektori bujqësor dhe sektori i shërbimeve kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 37,4 % dhe 42,9 %, ndërsa punësimi në industri përbën 19,8 % të të punësuarve gjithsej në vitin 2018.

Një pjesë e konsiderueshme e femrave në moshë pune punojnë si punëtore pa pagesë në biznesin e familjes, kryesisht në fermat bujqësore. Në vitin 2018, femrat kanë 1,8 herë më shumë gjasa sesa meshkujt për të qenë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes; 28,7 % e femrave të

SHKALLA E PUNËSIMIT, GRUPMOSHA 20-64 VJEÇ; 2018 %



SHKALLA E PUNËSIMIT, GRUPMOSHA 20-64 VJEÇ; 2018

	Njësia	2016	2017	2018
Popullsia gjithsej	1 000	2.876	2.877	2.870
Forcat e punës gjithsej	-	1.365	1.385	1.404
Meshkuj	-	773	795	791
Femra	-	592	590	613
Të punësuar gjithsej	-	1.157	1.195	1.230
Meshkuj	-	650	679	690
Femra	-	507	516	540
Shkalla e punësimit*	përqindje	55,9	57,4	59,5
Meshkuj	-	61,9	64,3	66,7
Femra	-	49,7	50,3	52,4

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2016-2018

*) llogaritur mbi popullsinë 15-64 vjeç




FORCAT E PUNËS

Shuma e personave të punësuar dhe të papunë në moshë 15 vjeç e lart.



TË RINJ TË MOSHËS 15-24 JO NË PUNËSIM DHE AS NË ARSIMIM APO TRAINIM (NEET),
(NË DISA VENDE TË RAJONIT) %



punësuar janë punëtorë pa pagesë në biznesin familjar, kundrejt 15,9 % të meshkujve të punësuar.

Në vitin 2018 përqindja e punësimit informal në sektorin jo-bujqësor është 29,4 %, duke pësuar një rënie me 0,9 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2017.



A EDINISE

Në vitin 2018, shkalla e inaktivitet-it në tregun e punës ka pësuar rënie krahasimisht me vitin paraardhës, nga 41,7 % në 40,6 %.



PAPUNËSIA

Shkalla e papunësisë, në 2018, për popullsinë e grup moshës 15 vjeç e lart arriti në 12,3 %, duke shënuar një ulje me 1,4 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

Shkalla e papunësisë ka pësuar ulje si për meshkujt edhe për femrat, krahasimisht me vitin 2017. Ky tregues, në vitin 2018 është 12,7 % për meshkujt dhe 11,9 % për femrat.

Gjatë vitit 2018, popullsia e grup moshës 15-24 vjeç pati ndikimin më të madh në nivelin e papunësisë. Shkalla e papunësisë për këtë grupmoshë, në vitin 2018 u ul në 28,3 %, nga 31,9 % që ishte në vitin 2017. Ky tregues u ul nga viti paraardhës me 4,5 pikë përqindje për meshkujt dhe 1,7 pikë përqindje për femrat.

Për popullsinë e grupmoshës 25-54 vjeç, niveli i papunësisë në vitin 2018 u ul në 11,2 %, nga 12,6 % që ishte në vitin 2017.

Të rinjtë e grupmoshës 15-24 vjeç të cilët nuk janë as në punë e as duke vazhduar shkollën apo ndonjë trajnim përbëjnë 26,5 % të të rinjve gjithsej, për vitin 2018.

PAPUNËSIA

	Njësia	2016	2017	2018
Të papunë	1 000	208	190	173
Meshkuj	-	123	116	100
Femra	-	85	74	73
Shkalla e papunësisë	%	15,2	13,7	12,3
Meshkuj	-	15,9	14,6	12,7
Femra	-	14,4	12,6	11,9

Burimi: Anketa e Forcave të Punës 2016-2018



SHKALLA E PAPUNËSISË

Të papunët si përqindje ndaj totalit të forcave të punës.

PAPUNËSIA

Personat 15-74 vjeç të cilët në një periudhë të caktuar reference plotësojnë njëkohësisht këto tre kritere: nuk kishin një punë, ishin duke kërkuar punë aktivisht dhe janë të gatshëm që të fillojnë punë nëse do t'u ofrohej një e tillë (në përputhje me definicionin e ILO-s).




A EDINISE

Shkalla e papunësisë së të rinjve 15-24 vjeç pësoi një rënie prej 3,6 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

ÇMIMET E KONSUMIT



NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I IÇK



NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I IÇK SIPAS GRUPEVE

		2016	2017	2018	%
000000	Gjithsej	1,3	2,0	2,0	Total of all items
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,3	3,9	2,7	Food, and non-alcoholic beverages
02.	Pije alkoolike dhe duhan	1,8	0,7	1,8	Alcoholic beverages and tobacco
03.	Veshje dhe këpucë	-1,1	-1,1	1,5	Clothing and footwear
04.	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	1,0	2,8	Rent, water, fuel and power
05.	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,7	-0,4	0,0	Furniture household and maintenance
06.	Shëndeti	-0,9	0,0	-0,2	Medical care
07.	Transporti	-2,9	1,9	2,4	Transport
08.	Komunikimi	-0,4	0,3	0,7	Communication
09.	Argëtim dhe kulturë	1,4	1,5	2,7	Recreation and culture
10.	Shërbimi arsimor	3,6	0,7	0,6	Education service
11.	Hotele, kafene dhe restorante	0,7	0,1	0,9	Hotels, coffee-house and restaurants
12.	Mallra dhe shërbime të ndryshme	1,0	2,2	0,2	Goods and various services

Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit në vitin 2018 është 2,0 %.

Rritja më e madhe e çmimeve prej 2,8 % vërehet në grupin “ Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” duke kontribuar me 0,58 pikë përqindje në ndryshimin vjetor. Indekset e grupit “Ushqime dhe pije alkoolike” dhe “Argëtim e kulturë” kanë shënuar një rritje prej 2,7 % secili, duke kontribuar respektivisht me +1,04 dhe + 0,07 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupit “Transport” ka shënuar një rritje prej 2,4 % me një ndikim prej +0,15 pikë përqindje, në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupi “Pije alkoolike dhe duhan” ka shënuar një rritje prej 1,8 %, duke ndikuar me +0,06 pikë përqindje, në ndryshimin mesatar vjetor.

Ulje më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shëndeti” me 0,2 %, duke kontribuar me -0,01 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor, në grupet e tjera ndryshimi vjetor varion nga -0,02 % në +1,8 %

A EDINISE

Në vitin 2018, indeksi i çmimeve të konsumit të nën-grupit “ushqime” shënoi një rritje 2,8 % nga 4,1 % që ishte një vit më parë.




PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

Gjatë vitit 2018, ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej 4,06 % krahasuar me vitin 2017, bazuar kjo mbi vlerësimin paraprak të PBB-së mbështetur në vlerësimet tremujore. Në vitin 2017, ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma realë (në volum) prej 3,82 %, krahasuar me vitin 2016, pas një rritje prej 3,31 % në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015.

Përsa i përket strukturës së PBB sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe për vitin 2018 vazhdojnë ta zënë Shërbimet gjithsej me 47,9 % të PBB, të cilat u rritën me 5,35 % në terma realë. Industria dhe Ndërtimi përbëjnë 21,3 % të Produktit të Brendshëm Bruto të cilat u rritën në terma realë përkatësisht: Industria me 13,6 % dhe Ndërtimi me 2,71 %. Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi përbëjnë 18,4 % të PBB-së dhe janë rritur me 1,42 % në terma realë.

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO



Llogaritë Kombëtare

Struktura e PBB sipas aktiviteteve kryesore (%)

	Njësia	2016*	2017**	2018***	2016*	2017**	2018**
PBB (me çmime korrente)	Mln lekë	1,472,479	1,551,281	1,626,196	100.0	100.0	100.0
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi (Nace Rev.2, A)	-	292,287	294,966	299,137	19.8	19.0	18.4
Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike & gazit (Nace Rev.2, B-E)	-	180,221	173,827	198,013	12.2	11.2	12.2
Ndërtimi (Nace Rev.2, F)	-	131,089	142,248	148,424	8.9	9.2	9.1
Shërbimet (Nace Rev.2, G-U)	-	687,606	744,085	779,066	46.7	48.0	47.9

2016* Të dhëna finale

LLOGARITË KOMBËTARE



Llogaritë Kombëtare					Struktura e PBB (%)		
	Njësia	2015	2016*	2017**	2015	2016*	2017**
Burimet (me çmime korrente)	Mln lekë	2.073.055	2.147.345	2.274.251			
PBB me çmime tregu	Mln lekë	1.434.307	1.472.479	1.551.281	100,0	100,0	100,0
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	-	638.749	674.866	722.969	44,5	45,8	46,6
Përdorimet (me çmime korrente)	-	2.073.055	2.147.345	2.274.251			
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	-	391.098	426.693	489.532	27,3	29,0	31,6
Konsumi Final i Popullatës	-	1.146.558	1.179.608	1.226.151	79,9	80,1	79,0
Konsumi Final i Administratës Publike dhe i Institucioneve Jo- fitimprurëse	-	170.213	178.465	188.744	11,9	12,1	12,2
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	-	350.164	358.813	380.551	24,4	24,4	24,5
Ndryshimet e gjendjeve dhe mospërputhje statistikore	-	15.022	3.766	-10.727	1,0	0,3	-0,7
Rritja vjetore e PBB (krahasuar me çmimet e vitit të mëparshëm)	%	2,22	3,31	3,82			
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	1.000 lekë	497.90	511.97	539.866			
	Euro	3.563	3.727	4.024			
	USD	3.953	4.124	4.533			

2016* Të dhëna finale

2017** Të dhëna gjysmë finale

Sipas PBB-së me metodën e shpenzimeve, Konsumi final përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 91,21 %. Ky komponent u rrit me 4,18 % në terma nominalë dhe 2,25 % në terma realë. Në strukturën e Konsumit Final është konsumi final i popullatës ai që zë peshën më të madhe me 79,04 %, i ndjekur nga konsumi i administratës publike me 11,46 % dhe konsumi i institucioneve jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve (IJFSHF) me 0,70 %. Në vitin 2017, Formimi bruto i kapitalit fiks, i cili përbën 24,53 % të PBB-së, u rrit me 6,06 % në terma nominalë dhe 5,51 % në terma realë, krahasuar me vitin 2016. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 14,73 %, në terma nominalë dhe me 12,94 % në terma realë, ndërkohë që Importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 7,13 %, në terma nominalë dhe 8,06 % në terma realë, krahasuar me vitin 2016.



A EDINISE

Sipas PBB-së me metodën e prodhimit, në vitin 2018, ekonomia shënoi një rritje ekonomike 4,06 % dhe kontributin kryesor e kanë dhënë degët e ekonomisë si "Industria, Energjia dhe Uji" me 1,52 pikë përqindje.



TREGTIA E JASHTME

Në vitin 2018, volumi tregtar i mallrave është rritur me 5,9 %, krahasuar me 2017, duke patur një rritje vjetore për eksportet rreth 13,7 % dhe 2,4 % për importet.


Grupet më të rëndësishme të mallrave që eksporton Shqipëria në vitin 2018 janë: “Tekstile dhe artikuj tekstile” me 20,3 %, “Veshjet e këmbëve” me 19,6 % dhe “Produktet minerale” me 18,2 %, të eksporteve gjithsej.

Grupet më të rëndësishme të mallrave që importon Shqipëria në vitin 2018 janë: “Makineri e pajisje mekanike dhe elektrike” me 14,9 % dhe “Tekstile dhe artikuj tekstile” me 11,2 %, të importeve gjithsej.

Tre nga partnerët kryesorë si për eksportet, ashtu edhe për importet për vitin 2018, janë Italia, Greqia dhe Gjermania, duke zënë rreth 56,6 % të eksporteve shqiptare dhe 43,2 % të importeve shqiptare.

Në vitin 2018, Greqia është partneri i dytë kryesor përsa i përket volumit tregtar duke zënë rreth 6,9 % të gjithë tregtisë së mallrave

TREGTIA E JASHTME DHE BILANCI TREGTAR I MALLRAVE



* Gjysmë-finale

** Paraprake

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE

milion lekë

	2008	2013	2018
Eksporte (FOB)	112.572	246.397	310.436
Importe (CIF)	439.894	517.378	641.452
Bilanci tregtar (Exports-Imports)	-327.322	-270.981	-331.016
Volumi tregtar (Exports+Imports)	552.466	763.774	951.888
Përqindja e mbulimit (%)	25,6	47,6	48,4



A EDINISE

Tre nga partnerët kryesorë si për eksportet, ashtu edhe për importet për vitin 2018, janë Italia, Greqia dhe Gjermania, duke zënë rreth 56,6 % të eksporteve shqiptare dhe 43,2 % të importeve shqiptare.

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË
NDËRMARRJE, 2015-2017

	2015	2016	2017
Ndërmarrje që përdorin kompjuter për qëllime pune	95,0	95,6	96,0
Punonjës që përdorin kompjuter në ndërmarrje për qëllime pune	24,4	28,0	28,1
Ndërmarrje që kanë akses në internet	96,2	96,8	96,9
Ndërmarrje që kanë faqe interneti	48,8	51,6	47,3
Ndërmarrje që përdorin media sociale për qëllime pune	37,4	38,9	46,8
Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime online	8,8	7,1	7,7

Ndërmarrjet që e kanë përdorur kompjuterin për qëllime pune gjatë vitit 2017, përfaqësojnë 96,0 % të ndërmarrjeve ekonomike, nga 95,6 % që ishte në 2016. Punonjësit që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune përbëjnë 28,1 % të të punësuarve gjithsej të ndërmarrjeve, nga 28,0 % që ishte në 2016.

Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në internet është 96,9 % e totalit të ndërmarrjeve që përdorin kompjuter, duke u rritur me 0,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016.

Në vitin 2017, ndërmarrjet që kanë pasur faqe interneti janë 47,3 % e totalit. Në 71,3 % të ndërmarrjeve, faqja e internetit është përdorur për të shfaqur katalogët e produkteve ose çmimet e tyre.


Në vitin 2017, media sociale (Facebook, LinkedIn, Twitter, Youtube etj.) është përdorur nga 46,8 % e ndërmarrjeve me 10 dhe më shumë të punësuar duke u rritur me 7,9 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016.

NDËRMARRJE QË SHESIN PRODUKTE/SHËRBIME ONLINE, 2017

Aktivitetet Ekonomike	Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime online
Industri përpunuese	3,8
En. elek., gaz, uji dhe trajtimi i mbetjeve	3,3
Ndërtim	0,4
Treg.shumicë dhe pakicë. Rip.i auto.&moto.	7,0
Transport dhe magazinim	25,2
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	12,6
Informacioni dhe komunikacioni	31,8
Pasuritë e patundshme	0,0
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	8,5
Shërbime administrative dhe mbështetëse	14,1
Riparimi i komp.&artikujve personal&familjarë	0,0



Në vitin 2017, vetëm 7,7 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/ shërbime nëpërmjet faqes së internetit apo aplikacioneve të dedikuara. Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e informacionit dhe komunikacionit me 31,8 %.



A EDINISE

Në vitin 2017, përqindja e përdorimit të kompjuterit me akses në internet nga ndërmarrjet në Shqipëri është vetëm 0,1 % më e ulët krahasuar me mesataren e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (97%).

MJEDISI




MBETJET URBANE DHE INERTE TË MANAXHUARA SIPAS QARQEVE, 2017

Qarqet	Mbetje Urbane		Mbetje Inerte
	Sasia Mbetje Urbane (tonë)	Kg/banorë	Sasia Mbetjet Inerte (tonë)
Gjithsej	1,253,913	437.00	162,330
Berat			
Dibër	18,826	155.60	14,570
Durrës	143,280	494.70	3,934
Elbasan	113,081	406.00	9,670
Fier	141,869	475.80	18,337
Gjirokastrë	89,571	426.20	36,897
Korçë	15,983	206.50	23,851
Kukës	49,870	393.30	12,221
Lezhë	36,134	574.00	2,465
Shkodër	99,483	485.30	2,650
Tiranë	388,169	439.10	22,995
Vlorë	93,294	492.90	6,518

Burimi i informacionit: INSTAT-Vrojtimi vetor 2018 mbi mbetjet urbanene vitin 2017

MBETJET URBANE DHE INERTE SIPAS QARQEVE NË VITIN 2017



Mbetjet - 2017

Mbetjet e ngurta urbane, janë mbetjet e ngurta familjare dhe mbetjet e tjera të ngjashme me to, të cilat menaxhohen me fonde publike si shërbime komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara qoftë dhe përkohësisht. Statistikat e mbetjeve urbane u referohen të dhënave vjetore të përgjithësuara në nivel vendi për prodhimin e treguesve statistikor standard, sipas përcaktimeve në legjislacionin Shqiptar dhe atij Evropian. Treguesit mbi sasinë e mbetjeve për banorë, i referohen popullsisë rezidente dhe sasisë totale të mbetjeve të menaxhuara me fonde publike, nën kujdesin e bashkive në të gjithë vendin. Në vitin 2017 rezulton të jenë menaxhuar 1,25 milion tonë mbetje nga 1,30 milion tonë, në vitin 2016, duke shënuar një rënie me rreth 8 pikë përqindje.



Sasia vjetore e mbetjeve të menaxhuara për banorë në shkallë vendi, ka patur luhatje të vazhdueshme. Kjo shifër është 437 kg/banorë në vitin 2017 dhe 452 kg/banorë në vitin 2016, duke shënuar ulje me rreth 3,5 %.

MBETJE URBANE TË MENAXHUARA NË VITE

Vitet	000/Ton	Total menaxhuar Kg/Ban/Vit
2013	940	356
2014	1.229	425
2015	1.413	490
2016	1.300	452
2017	1.254	437



A EDINISE

"Sasia e mbetjeve të menaxhuara për banorë rezidentë vitet e fundit ka tendencë në ulje ndërsa, shkalla e mbulimit të popullatës me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane nga bashkitë, ka tendencë rritje."

PLAZHET



CILËSIA E UJRAVE NË PLAZHET E SHQIPËRISË

Stacione* Plazhet	2014	2015	2016	2017
Velipojë	7	7	7	7
Tale				3
Shëngjin	5	5	5	5
Durrës	21	21	21	21
Kavajë	10	10	9	15
Seman				3
Vlorë	11	11	10	16
Dhërmi	3	3	4	5
Palasë				2
Himarë	4	4	5	5
Borsh	3	3	3	3
Sarandë	6	6	6	6
Gjiri i Lalzit	3	3	3	3
Qeparo	2	2	2	2
Ksamil	3	3	3	3

Plazhet - 2017

Në vitin 2017 plazhet me cilësinë më të mirë të ujrave rezultojnë plazhi i Dhërmiut, Himarës dhe Borshi, ku respektivisht 100 % e stacioneve të vrojtuar janë vlerësuar me cilësi të shkëlqyer. Treguesit e cilësisë së ujërave larës në plazhet e Shqipërisë, kanë qëndruar përgjithësisht në të njëjtat nivele, me cilësi të shkëlqyer ose të mirë, në 85 % të tyre. Të dhënat për cilësinë e ujrave në plazhet e Shqipërisë, u referohen matjeve të përsëritura në të gjitha plazhet detare. Këto të dhëna i referohen kryesisht përmbajtjes së kolonive të baktereve me origjinë nga shkarkimet në ujërat detare dhe ujërat e brendshme.

A EDINISE

“Ndotja e ujit në plazhe dëmton direkt shëndetin e atyre që bëjnë plazh dhe indirekt ekonominë”



* Shënim: Numri i stacioneve të monitoruara në plazhe

* Cilësia shpreh shkallën në përqindje të plotësisht të standardeve cilësore sipas OBSH në plazhet përkatëse

Burimi i informacionit: Agjencia Kombetare e Mjedisit



PESHKIMI

Peshkimi


Aktiviteti i peshkimit i referohet të gjitha veprimtarive të lidhura me kërkimin e peshkut, vendosjen dhe tërheqjen e mjeteve të peshkimit, transferimin në bord të zënieve, trasbordimin, ruajtjen dhe transformimin në bord, vendosjen në kosha, rritjen dhe shkarkimin e peshqve dhe produkteve të peshkimit. Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustanceve, molusqeve, etj.), specieve të ujrave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

Zënia e peshkut gjatë vitit 2018, ka pësuar rritje me rreth 20,0 %, krahasuar me vitin 2017. Sektori i Akuakulturës është rritur me ritme të shpejta, si një sektor i ri dhe me perspektivë. Gjatë vitit 2018, u kultivuan në rezervate dhe vaska të ndryshme të specializuara, rreth 5.138 ton peshk ose rreth 28,5 % më shumë se në vitin 2017. Kjo sasi përfaqëson rreth 35,0 % të prodhimit total të peshkut, mbas atij detar me 37,0 %.


PESHKIMI

Kategoritë	2016	2017	2018
Total Peshkimi (1+2+3+4)	12.534	12.719	14.875
Detar	4.646	4.609	5.537
Bregdeti	952	1.074	315
Laguna	598	599	350
Ujërat e brendshme	1.688	2.007	2.427
Akuakultura	3.200	4.000	5.138
Molusqe	1.450	430	1.108

PESHKIMI SIPAS KATEGORIVE UJORE



PESHKIMI SIPAS KATEGORIVE UJORE



A EDINISE

Zënia e peshkut gjatë vitit 2018, ka pësuar rritje me rreth 20,0 %, krahasuar me vitin 2017.

BLEGTORIA



NUMRI I BAGËTIVE, (000 KRERË)

Tregues	2016	2017	2018
Gjedhë	492,4	475,2	467,3
- Lopë	354,9	349,2	342,7
Të imta	2.912,7	2.858,6	2.781,0
Të leshta	1.971,9	1.925,5	1.863,8
- Dele	1.428,0	1.407,3	1.366,2
Të dhirta	940,8	933,1	917,2
- Dhi	716,2	717,4	894,0
Derra	181,0	180,1	184,1
- Dosa	12,7	11,8	12,1
Njethundrakë	71,1	88,6	88,4
Shpendë	8.325,6	7.834,6	8.362,5
(koshere)	303,0	290,0	285,5

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

PRODHIMET BLEGTORALE, (000 TON)

Treguesit	2016	2017	2018
Qumësht	1.145,1	1.156,3	1.144,4
Qumësht lope	974,7	982,5	973,5
Qumësht dele	85,4	86,9	84,8
Qumësht dhie	85,0	86,8	86,0
Mish peshë e gjallë	159,8	161,3	161,4
Mish gjedhi	72,1	72,3	68,8
Mish të imtash	50,6	52,0	55,9
Mish derri	17,3	17,0	16,9
Mish shpendi	19,7	20,0	19,7
Lesh (ton)	3.431,0	3.123,0	3.331,2
Vezë (në mil)	830,0	811,0	827,5
Mjaltë (ton)	3.923,0	3.614,0	3.936,7

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Gjatë vitit 2018 vihet re një tendencë në rënie e numrit të krerëve të blegtorisë. Krahasuar me një vit më parë rënie ka pësuar numri i gjedhëve me rreth 1,7 %, numri i të leshtave me 3,2 % dhe numri i të dhirtave me 1,7 %. Ndërkohë rritje ka shënuar numri i shpendëve me 6,7 % dhe numri i derrave me rreth 2,2 %. Nga ana tjetër një vëmendje të veçantë po merr mbarështimi bletëve ku vërehet një zgjerim i aktivitetit të fermerëve në disa zona të vendit. Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 rritje ka shënuar prodhimi i mjaltit me 8,9 %, prodhimi i vezëve me 2,0 % dhe prodhimi i mishit me 0,1 %.

Prodhimi i qumështit, ka pësuar një rënie me 1,0 % krahasuar me vitin 2017 dhe ndërkohë struktura e prodhimit të qumështit është: qumësht lope 85,1 %, qumësht dele 7,4 %, qumësht dhie 7,5 %.



A EDINI SE

një vëmendje të veçantë po merr mbarështimi bletëve ku vërehet një zgjerim i aktivitetit të fermerëve në disa zona të vendit.



BUJQËSIA

Bimët e arave

Gjatë vitit 2018 vihet re një tendencë në rritje e prodhimit bujqësor. Prodhimi i perimeve në 2018, në krahasim me 2017 është rritur me 1,24 %. Rritje ka gjithashtu prodhimi i fasules dhe patates me respektivisht 15,8 % dhe 1,9%. për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017. Nga ana tjetër prodhimi i dritherave ka rënë me 3,3 % në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Gjithashtu një rënie më e lehtë vihet re në prodhimin e bimëve aromatike, mjekësore dhe erëzave të gatimit me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë. Prodhimi bimëve aromatike, mjekësore dhe erëzave të gatimitlave në vitin 2018 arrin në 12.531 ton.

Sipërfaqja e mbjellë me bimë arash

000 Ha

Bimët e arave	2016	2017	2018
Drithëra	148,0	145,8	140,1
Grurë	70,5	68,1	65,1
Misër	58,5	58,1	54,1
Thekër	1,2	1,2	1,0
Elb	3,1	3,1	3,4
Tërshere	14,7	15,4	16,6
Perime & bostanore	31,2	31,9	31,7
Patate	9,7	9,9	9,7
Fasule	13,7	13,0	13,4
Bimë industriale	2	2	1,6
Duhan	1,1	0,9	1,0
Luledielli	0,7	0,5	0,4
Sojë	0,3	0,2	0,3
Bimë aromatike, mjekësore dhe erëza gatimi	5,0	5,4	5,6
Foragjere të njoma	208,6	215,7	217,4

Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



A EDINISE

Prodhimi perimeve ka pësuar rritje si rezultat i mbjelljeve të hershme dhe rritjes së sipërfaqes së perimeve në serra. Gjithashtu në këtë rritje kanë ndikuar dhe përdorimi i farave dhe fidanave cilësor.



Prodhimi i drufrutorëve

000 ton

Drufrutorët	2016	2017	2018
Pemë frutore	262	263	274
Ullinj	99	108	118
Agrume	40	41	45
Rrush Gjithsej	205	203	185
Rrush nga vreshtat	122	123	110
Rrush nga pjergullat	83	80	74

Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Prodhimi i perimeve në serra

000 ton

Perime	2016	2017	2018
Gjithesej perime në serra	213	244	254
Domate	133	144	140
Spec	17	20	22
Kastravec	45	63	71
Të tjera perime në serra	18	18	21

Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



AEDINISE

Rritja e prodhimit të agrumeve me 10,0 % dhe pemëve frutore me 4,5 % ka ardhur si rezultat i rritjes së sipërfaqes së blloqeve dhe mënyrës intensive të kultivimit të tyre.

Drufrutorët

Prodhimi i drufrutoreve ka njohur rritje nga viti në vit. Prodhimi i pemëve frutore në 2018 është rritur 4,5% krahasuar me vitin 2017, ulliri me 9,0%, agrumet 10,0%, ndërsa prodhimi i rrushit ka pësuar rënie me 8,9% krahasuar me një vit më parë.

Prodhimi i bimëve të arave

000/ton

Bimët e arave	2016	2017	2018
Drithëra buke	698,4	701,7	678,2
Grurë	275,0	274,9	240,3
Misër	379,7	381,1	391,1
Thekër	2,7	2,7	2,3
Elb	9,0	9,0	9,7
Tagjira	32,0	34,1	34,9
Perime & bostanore	1.129	1.152	1.166
Patate	238,3	249,8	254,5
Fasule	24,8	21,2	24,5
Bimë industriale	4,5	3,0	3,3
Duhan	1,8	1,4	1,7
Luledielli	2,0	1,1	0,8
Sojë	0,7	0,5	0,7
Bimë aromatike, mjekësore dhe erëza gatimi	10,6	12,8	12,5
Foragjere të njoma	6.144	6.689	7.050

Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural




TRANSPORTI

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat detare në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, është rritur me 1,0 %, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat ajrore me 12,0 % dhe atyre që udhëtojnë me linjat hekurudhore është rritur me 15,0 %.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër në vitin 2018, zë 64,8 % të numrit të pasagjerëve gjithsej që udhëtojnë (me det, ajër dhe hekurudhë), i ndjekur nga numri i pasagjerëve që udhëtojnë me det me 33,5 % dhe me hekurudhë me 1,7 %.

LËVIZJA E MALLRAVE SIPAS MËNYRËS SË TRANSPORTIT 2017

	Eksportet		Importet	
	milionë lekë	% ndaj gjithsej	milionë lekë	% ndaj gjithsej
Gjithsej	272.988	100,0	626.176	100,0
Transporti detar	171.468	62,8	304.255	48,6
Transporti rrugor	97.812	35,8	279.540	44,6
Transporti ajror	1.300	0,5	17.868	2,9
Mënyra të tjera transporti	2.408	0,9	24.513	3,9



NUMRI I PASAGJERËVE QË UDHËTOJNË ME MJETE TË TRANSPORTIT DETAR, AJROR DHE HEKURUDHOR

	2016	2017	2018
Transporti detar i pasagjerëve	1.288.988	1.507.116	1.522.896
Transporti ajror i pasagjerëve	2.195.100	2.630.338	2.947.172
Transporti hekurudhor i pasagjerëve	88.690	65.980	75.881



Në vitin 2017 mallrat e transportura nëpërmjet detit zënë rreth 62,8 % të eksporteve shqiptare dhe rreth 48,6 % të importeve shqiptare



A EDINISE

Në vitin 2017, rreth 52,9 % e volumit tregtar të mallrave është transportuar me det. Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër, zë 62,6 %, më shumë se gjysmën e pasagjerëve gjithsej.



HYRJET E JO -RESIDENTËVE NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE, SIPAS KOMBËSISË

	2016	2017	2018
Gjithsej	4.735.511	5.117.700	5.926.803
I . Afrika	1.077	2.080	3.457
II. Amerika	103.839	123.729	148.845
III.Azia Lindore dhe Paqësori	35.894	53.533	68.121
IV.Lindja e Mesme	4.324	4.722	7.174
V. Azia e Jugut	1.699	2.216	3.115
VI. Evropa	4.485.405	4.686.695	5.331.614
Evropa Qëndrore / Lindore	182.581	269.261	362.083
- Evropa Veriore	149.965	204.099	212.246
- Evropa Jugore	3.855.617	3.810.337	4.301.996
- Evropa Perëndimore	221.492	316.120	357.411
- Evropa Lindore / Mesdheut	75.750	86.878	97.878
VII. Rajone të paspecifikuara	103.273	244.725	364.477

Hyrjet e shtetasve të huaj në pikat kufitare, për vitin 2018 janë rritur me 15,8 %, ndërsa daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur me 4,4 %, krahasuar me vitin 2017.

Në vitin 2018, hyrjet e shtetasve të huaj nga rajoni i Evropës, zënë peshën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej, me 90,0 %.

Evropa Jugore zë përqindjen më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj, me 80,7 % të hyrjeve gjithsej nga Evropa. Hyrjet nga Kosova zënë 39,2 % të hyrjeve të Evropës Jugore, të ndjekura nga Maqedonia me 12,8 % dhe Mali i Zi me 6,7 %.

Hyrjet e shtetasve të huaj nga rajonet e tjera, zënë 10,0 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.

DALJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ, NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE

	2016	2017	2018
Hyrjet e shtetasve të huaj	4,735	5,118	5,927
Daljet e shtetasve shqiptarë	4,852	5,186	5,415



A EDINISE

Gjatë vitit 2018, hyrjet e shtetasve të huaj nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, zënë 52,7 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.

